

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 617 Prot.

Tiranë, më 14.09 2015

VENDIM Nr. 100, datë 1.09.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore” (i ndryshuar), dhe VKM Nr. 280, datë 1.4.2015 për "Përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesa anësore dhe/ose lartësi, në ndërtimet me leje", Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.11, të datës 1.09.2015, pasi shqyrtoi kërkesën për legalizim objekti në emër të z. Astrit Meçaj, i cili pozicionohet brenda zonës arkeologjike "B" të qytetit të Vlorës, paraqitur nga Drejtoria e ALUIZNI-t Vlorë,

VENDOSI:

- I. Të rishqyrtojë në KKA e rradhës kërkesën për legalizim objekti në emër të z. Astrit Meçaj, i cili pozicionohet brenda zonës arkeologjike "B" të qytetit të Vlorës, paraqitur nga Drejtoria e ALUIZNI-t Vlorë, pasi informacioni i sjellë nga DRKK Vlorë në lidhje me potencialin arkeologjik *të sheshit ku pozicionohet ky objekt* është i pamjaftueshëm për KKA, për të gjykuar në lidhje me këtë legalizim.
- II. DRKK Vlorë duhet të hartojë një *informacion të plotë në lidhje me potencialin arkeologjik të sheshit ku pozicionohet objekti për legalizim*, i cili duhet të shoqërojë kërkesën me dokumentacionin përkatës, përcjellë nga ALUIZNI Vlorë pranë ASHA.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO